



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura VIII
Sesioni pranveror

Komisioni për Punë të Jashtme dhe Diasporë
Mbledhja nr. 5
Prishtinë, më 15.6.2021, në orën 10:00
Ndërtesa e Kuvendit, salla N-303

P r o c e s v e r b a l

Në mbledhje morën pjesë: Haki Abazi, Xhavit Haliti, Branislav Nikoliq, Adelina Grainca, Dimal Basha, Gazmend Gjyshinca, Fitore Pacolli-Dalipi, Ariana Musliu-Shoshi, Time Kadrijaj dhe Bahrim Shabani.

Mungoi: Kujtim Shala.

Pjesëmarrës të tjerë: Fatjeta Ibishi, Kuvend; Arbreshë Asllani, GP-AAK; Liridona Gashi, Arbenita Mjekiqi, kabinet-Kuvend; Stina Fejza, LVV; Ermira Gashi, Kuvend; Granit Bllaca, KDI dhe Genta Lepaja, Kuvend.

Nga Zyra e Komisionit: Minire Hasani dhe Manush Krasniqi.

Takimin e kryesoi: Haki Abazi, kryetari i komisionit.

Rendi i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbaleve nga mbledhjet e mbajtura më 5 e 25 maj, si dhe më 3 qershor 2021;
3. Shqyrtimi i kërkesës për formimin e Grupit të Miqësisë;
4. Diskutim lidhur me propozimin për anëtarë të grupeve të miqësisë;
5. Plani për mbikëqyrjen e procesit integruar 2020-2021 dhe inkuadrimi i të gjeturave në planin e punës së komisionit;
6. Të ndryshme.

1. Miratimi i rendit të ditës

Kryetari konstatoi se komisioni e miratoi rendin e ditës.

2. Miratimi i procesverbaleve nga mbledhjet e mbajtura më 5 e 25 maj, si dhe më 3 qershor 2021

Kryetari konstatoi se komisioni i miratoi procesverbalet nga mbledhjet e mbajtura më 5 dhe 25 maj 2021, si dhe procesverbalin nga mbledhja e mbajtur më 3 qershor 2021, me plotësimin nga deputeti Dimal Basha, që në përfundimin e diskutimit të tij, të shtohet fjalia si në vijim: “Gjithashtu u cek që izolimi i Kosovës në BE lë hapësirë për rryma tjera në vend e rajon.”

3. Shqyrtimi i kërkesës për formimin e Grupit të Miqësisë

Haki Abazi, njoftoi se më datë 9 qershor 2021, komisionit i është përcjellë një kërkesë për themelimin e Grupit të Miqësisë në mes të deputetëve të Kuvendit të Kosovës dhe të Tajvanit, e parashtruar nga deputetët: Adriana Matoshi, Armend Zemaj, Duda Balje, Blerta Deliu-Kodra, dhe Bekë Berisha. Ai njoftoi për qëllimin e propozimit të formimit të Grupit të Miqësisë Kosovë-Tajvan, të propozuar nga deputetët nënshkrues. Lidhur me formimin e këtij Grupi të Miqësisë, tha se meqenëse statusi i Tajvanit është specifik dhe raporti ynë me këtë shtet mund të ketë implikime, sidomos në interesin tonë në raport me Kinën, në të ardhmen.

Gazmend Gjyshinca, sa i përket kërkesës për formimin e këtij Grupi të Miqësisë, tha se është mirë të koordinohemi me qendrat politike, të cilat janë orientim i politikës sonë të jashtme, SHBA e BE. Ai theksoi se nuk është kundër formimit të këtij Grupi të Miqësisë, mirëpo formimi i tij do të duhej të trajtohej me shumë kujdes, ngase kemi të bëjmë me një çështje shumë të ndjeshme, duke pasur parasysh atë se përballë e kemi një shtet të fuqishëm dhe shumë aktiv në politikën e jashtme, Republikën Popullore të Kinës.

Dimal Basha, propozoi që, për formimin e Grupit të Miqësisë me Tajvanin, komisioni të koordinohet me MPJD-në, deputetët propozues dhe ambasadat, meqë kjo temë i tejkalon kompetencat e komisionit.

Xhavit Haliti, sa i përket propozimit për formimin e Grupit të Miqësisë Kosovë-Tajvan, tha se është mirë që kjo kërkesë t’i përcillet Kryesisë së Kuvendit, e më pas Kryesia të na kthejë një përgjigje se a mund të formojmë këtë Grup të Miqësisë. Ai shtoi se Tajvani ka pasur edhe një përpjekje të mëhershme për të krijuar raporte miqësore me Kosovën, ka kontribuar dhe ka investuar në Kosovë, mirëpo është mirë që kjo çështje t’i përcillet Kryesisë së Kuvendit.

Ariana Musliu-Shoshi, theksoi se pajtohet me parafolësit, se kjo kërkesë duhet t’i dërgohet Kryesisë së Kuvendit, pasi që sipas Rregullores së Kuvendit, Kryesia udhëheq politikën e jashtme të Kuvendit dhe më pas ajo të na njoftojë lidhur me këtë çështje.

Fitore Pacolli-Dalipi, propozoi që kjo kërkesë t'i dërgohet MPJD-së dhe Kryesisë së Kuvendit, në mënyrë që ministria ta bëjë komunikim e nevojshëm me ambasadat dhe të kërkojmë mendimin e tyre lidhur me këtë kërkesë.

Haki Abazi, propozoi që komisioni t'i drejtohet Kryesisë, me kërkesën dhe sugjerimin, që mund të ketë implikimi i këtij Grupi të Miqësisë, e më pas kjo çështje të kthehet në komision, nëse duhet të marrim vendimin përfundimtar. Një rrugë tjetër që mund ta ndjekim, tha ai, është që parashtruesit e kërkesës të na njoftojnë se ku është marrë motivacioni për këtë propozim. Nëse iniciativa është direkt nga Tajvani, duhet të analizojmë se cili është interesi ynë që të kemi këtë grup të miqësisë, e po ashtu është mirë që të marrim më tepër informata lidhur me këtë çështje.

Pas diskutimeve, komisioni, njëzëri, nxori këtë:

Përfundim

- I. Kërkohet nga Kryesia e Kuvendit që t'i shqyrtojë ndikimet e mundshme në politikën e jashtme të Kosovës, me rastin e formimit të Grupit të Miqësisë në mes të deputetëve të Kuvendit të Kosovës dhe deputetëve të Tajvanit.
- II. Kryesia e Kuvendit ta njoftojë Komisionin për Punë të Jashtme dhe Diasporë, lidhur me qëndrimin e saj për formimin e këtij Grupi të Miqësisë.

4. Diskutim lidhur me propozimin për anëtarë të grupeve të miqësisë

Haki Abazi, njoftoi se komisioni, në mbledhjen e mbajtur më 5 maj 2021, e ka shqyrtuar Përfundimin nr. 08-P-007, lidhur me formimin e grupeve të miqësisë nga Kryetari i Kuvendit, me kërkesë që komisioni të përgatisë propozim-vendimin për numrin dhe përbërjen e grupeve të miqësisë në mes të deputetëve të Kuvendit tonë, me deputetët e parlamenteve të shteteve të tjera. Ai, më tej, shtoi se komisioni është përcaktuar për formimin e 56 grupeve të miqësisë, bazuar në grupet e miqësisë nga legjislatura e kaluar, ndërsa për përbërjen e tyre ka vendosur që të kërkojë nga grupet parlamentare të përcjellin anëtarët e këtyre grupeve. Më tej, z. Abazi njoftoi se komisioni i është drejtuar me shkrim të gjitha grupeve parlamentare, që të përcjellin anëtarët për 56 grupe të miqësisë, por kërkesës së komisionit i është përgjigjur vetëm GP-AAK. Ai kërkoi nga deputetët që grupet e tyre parlamentare, përveç GP-AAK, t'i përcjellin në komision propozimet e tyre për anëtarë të grupeve të miqësisë.

5. Plani për mbikëqyrjen e procesit integrues 2020-2021 dhe inkuadrimi i të gjeturave në planin e punës së komisionit

Haki Abazi, njoftoi se pas analizës së Raportit për Kosovën për vitin 2020, janë paraqitur gjetjet dhe rekomandimet e raportit sipas mandatit të secilit komision parlamentar. Komisionet parlamentare sipas Planit për mbikëqyrjen e procesit integrues 2020-2021, duhet t'i integrojnë rekomandimet që dalin nga ky dokument në planet e tyre vjetor të punës, për vitin 2021. Të gjeturat nga Raporti për Kosovën, në mandatin e këtij komisioni janë marrëdhëniet e mira fqinjësore dhe bashkëpunimi rajonal, si dhe normalizimi i marrëdhënieve mes Kosovës dhe Serbisë. Ai tha se

këto rekomandime janë të përfshira në planin e punës së këtij komisioni dhe propozoi që në rekomandimin e dytë, përveç normalizimit, t'i shtohen edhe fjalët: “njohjen e dyanshme”.

Pas diskutimeve, komisioni, me shumicë votash, nxori këtë:

Përfundim

Komisioni do jetë përgjegjës për mbikëqyrjen e Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës, si dhe Zyrës së Kryeministrit, lidhur me zbatimin e rekomandimeve të dala nga Raporti për Kosovën 2020, si pjesë të planit të tij të punës dhe atë si vijon:

1. Kosova të vazhdojë të zhvillojë raporte të mira fqinjësore dhe të jetë pjesë aktive e bashkëpunimit rajonal;
2. Kosova të ndër marrë hapa drejtë arritjes së marrëveshjes gjithëpërfshirëse, ligjërish të obligueshme, për normalizimin e marrëdhënieve me Serbinë dhe njohjen e dyanshme.

6. Të ndryshme

Ariana Musliu-Shoshi, kërkoi që komisioni të njoftohet dhe t'i përcillen raportet nga takimet me organizatat ndërkombëtare dhe rajonale, si dhe për aktivitet që i mban Kuvendi. Ajo tha se ne duhet të jemi të informuar për çështjet që diskutohen dhe nuk kanë marrë asnjë raport as për Asambleenë Parlamentare të Këshillit të Evropës, as AP të NATO-së e as për SEECP.

Xhavit Haliti, tha se zakonisht raportimet i bëhen Kryesisë, por është mirë që të kërkohet që ato t'i sillen edhe komisionit, për shkak të natyrës së tij.

Dimal Basha, tha se punën e këtij komisioni mund ta specifikojmë në dy nivele. Niveli i parë lidhet me liberalizimin e vizave, me ç' rast nevojitet rritja e bashkëpunimit me kuvendet e vendeve që janë pengesë për liberalizimin e vizave, si dhe niveli i dytë duhet të jetë i lidhur me angazhimin e komisionit në drejtim të 5 vendeve që nuk e kanë njohur Kosovën.

Lidhur me këto propozime, tha se tani pas situatës më të mirë nga Covid-19, mundësitë për bashkëpunim janë rritur dhe mund të realizohen edhe vizita në këtë drejtim.

Gazmend Gjyshinca, theksoi se pajtohet me propozimin e deputetes Shoshi, që komisionit t'i sillen raportet nga takimet ndërkombëtare e rajonale të delegacioneve të Kuvendit, si dhe të njoftohen se cilët nga deputetët na përfaqësojnë në këto mekanizma.

Fitore Pacolli-Dalipi, tha se anëtarët që janë në këto organizata, janë të deleguar nga partitë politike dhe kanë mandat. Njoftoi se do të raportojë në Kuvend, lidhur me takimin e SEECP-së.

Haki Abazi, tha se raportet nga takimet janë pritshme, por është e rëndësishme që të kemi edhe forma të inicimit për pozicionin e Kosovës në këto forume dhe të dalim me rekomandime edhe për Kryesinë edhe për ata që përfaqësojnë në organizata edhe për MPJD-në, e që do të ishte një kontribut i frytshëm nga ne. Lidhur me diskutimin e deputetit Basha, tha se komisioni sipas planit të tij të punës, ka përcaktuar angazhimet e tij. Më tej, z. Abazi tha se mund të krijohet një praktikë që në takimet e rregullta të komisionit, për disa minuta, të njoftojë anëtarët lidhur me angazhimet

të cilat është duke i bërë ndërkohë. Qasja ndaj 5 vendeve mosnjohëse, është e vështirë në kuptimin e komunikimit direkt, ngase nuk kanë disponim të angazhohen direkt në institucionet tona, por është një lloj qasje e dyanshme në kuptimin e formave alternative. Në këtë drejtim, njoftoi se gjatë takimit online me kryetarin e Komisionit të Parlamentit të Lituanisë, u dakordua për disa qëndrime lidhur me liberalizimin e vizave për Kosovën, të cilat ai ka pranuar t'ia përcjellë delegacionit të Parlamentit francez, që ishin prezent në Lituani.

Ai tha se është i mirëseardhur çfarëdolloj koordinimi, për të depërtuar te shtetet, të cilat momentalisht paraqesin pengesa për liberalizimin e vizave, si Franca e Holanda e po ashtu edhe ndaj 5 vendeve mosnjohëse, të shikohet aspekti alternativ i qasjes ndaj tyre. Për çështjen e liberalizimit të vizave, tha se duhet t'i ndihmojmë institucionet, që të kemi një koordinim dhe paraqitje kolezive, sa i përket pozicionit tonë. Po ashtu, z. Abazi njoftoi anëtarët e komisionit se ka takime të rregullta dyjavore bashkëpunimi me ministren.

Fitore Pacolli-Dalipi, propozoi që kryetari i Komisionit, pasi që të vendosë kontaktet me kryetarët e komisioneve parlamentare të shteteve të tjera, në takimet e dyta me ta, t'i ftojë edhe anëtarët e komisionit.

Haki Abazi, propozimin e deputetes Pacolli e vlerësoi si shumë të mirë dhe njoftoi se me cilët kryetarë të komisioneve të jashtme deri më tani ka iniciuar takime dhe në atë nivel i ka mbajtur diskutimet fillestare. Ai tha se këto kanë qenë takime kontakti, të cilat po mundohet t'i kthejë në përmbajtje, në mënyrë që ato delegacione të vijnë këtu ose komisioni të bëjë vizita atje. Ai shtoi se është i mirëseardhur çfarëdo sugjerimi që kanë anëtarët e komisionit, në cilëndo fazë dhe se patjetër këto takime do t'i mbajë me anëtarët e komisionit.

Dimal Basha, njoftoi se në mandatin e kaluar, në Komisionin për Legjislacion, kur kryetari ka dalë jashtë komisionit për ta përfaqësuar atë, ai ka marrë miratimin nga komisioni. Këto praktika do ta lehtësonin punën komisionit, si dhe nëse bëhet një raport, ku tregohet se çfarë qëndrimi kanë kryetarët e komisioneve të shteteve me të cilët janë zhvilluar takimet. Sa i përket liberalizimit të vizave, tha se është mirë që të kërkojmë nga Komisioni i Punëve të Jashtme të Holandës, që të kemi një takim bilateral, përmes platformës zoom, ku mund t'i shprehim disa shqetësime dhe qëndrime tona lidhur me vakumet dhe rreziqet e mosliberalizimit të vizave, në mënyrë që ata së paku të ulin tensionin te qeveria e tyre.

Xhavit Haliti, tha se pasi që ky është një komision parlamentar edhe diplomacia parlamentare është më e pranueshme se ajo ekzekutive, sidomos në raport me 5 vendet e BE-së që nuk e kanë njohur pavarësinë e Kosovës. Këto shtete e kanë të vështirë të pranojnë ministrin e Punëve të Jashtme, por nuk e kanë të vështirë të pranojnë ftesë nga ky komision për ta vizituar Kosovën dhe se këto nisma lobuese janë më të pranueshme për ta. Ai shtoi se i përfaqëson interesat e partisë së tij dhe të opozitës, në raport me politikën që ndërton Qeveria, kurse LVV ka për t'i mbrojtur interesat dhe qëndrimet e Qeverisë.

Fitore Pacolli-Dalipi, kërkoi të ketë bashkëpunim në mes të kryetarit dhe anëtarëve të komisionit, pra kryetari mos të jetë vetëm ai që i udhëheq gjërat, por ta marrë miratimin dhe koordinimin e anëtarëve të komisionit. Qëllimi i anëtarëve të këtij komisioni, është avancimi i agjendës së politikës së jashtme të Kosovës dhe t'i ndihmojë agjendës së përgjithshme shtetërore, pasi që është

interes shtetëror që Kosova të përfaqësohet sa më drejt jashtë Kosovës, të zgjerohet bashkëpunimi, të arrihen njohjet nga 5 vendet e BE-së, si dhe Kosova të shkojë drejtë integritit në BE.

Xhavit Haliti, propozoi që për një funksionim më të mirë të punës së komisionit, të nxirret një rregullore e brendshme dhe të funksionojmë në bazë të asaj.

Dimal Basha, duke u ndërlidhur me diskutimin e deputetit Haliti, tha se ka qenë pjesë e grupit punues për hartimin e Rregullores së re të Kuvendit, e cila ka qenë në përfundim e sipër dhe bëri të ditur se me këtë rregullore do të sqarohen më në hollësi disa çështje, sa i përket punës në komisionet parlamentare.

Xhavit Haliti, njoftoi se i ka përcjellë mbledhjet e komisioneve në Këshillin e Evropës dhe seancat e Asamblesë Parlamentare, afërsisht për 10 vite me radhë. Më tej, tha se aty ka beteja, por në fund vendoset me votë. Ai shprehu mendimin se në Kuvend ka nevojë për një komision qendror që do të duhej të ishte komisioni për politikë dhe demokraci, ashtu siç e ka KE-ja dhe çështjet që kalojnë aty, pastaj në seancë.

Time Kadrijaj, tha se është praktikë që në komisionet parlamentare, politikat partiake të lihen jashtë, sepse kemi të bëjmë me mbikëqyrjen e punës së Qeverisë. Po ashtu, tha se është praktikë që kryetari i komisionit, paraprakisht ta marrë miratimin e komisionit, kur ka ndonjë çështje të rëndësishme, që ka të bëjë me punën e komisionit. Ajo shtoi se duhet të merret miratimi i komisionit, para se të ftohet në raportim një ministër. Në vijim, tha se është mirë që komisioni të ketë unitet, pasi që ky komision përfaqëson unitetin dhe politika e jashtme është një dhe nuk është politikë partiake.

Mbledhja përfundoi në orën 11:20.

E përgatiti:
Stafi mbështetës i komisionit.

Kryetar i komisionit,

Haki Abazi